



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË



SHËRBIMI I PROVËS



Nr. 826 / 12 prot., datë 31.10.2025

Nr. 17210/1 prot., datë 29.10.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Sot më datë ____ 2025, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi e re midis palëve, si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me adresë: Rruga “*Jordan Misja*”, Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm (në mungesë), Drejtori i Mbikëqyrjes Elektronike **Z. Eris SHESHI**,

dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me adresë: Rruga “*Zef Serembe*”, Tufinë, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Klevis QOSE**.

DUKE MARRË NË KONSIDERATË:

- Qëllimin e përbashkët për funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe përmbushjen e objektivave;
- Nevojën për një bashkëpunim ndërinstitucional në ofrimin e shërbimeve më efektive;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi si më poshtë:

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje është përcaktimi i procedurave, formave dhe metodikës së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës (DPShP) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), lidhur me:

- zhvillimin e takimeve të specialistëve të Shërbimit të Provës me të dënuarit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP);
- asistencën në hartimin e raporteve të vlerësimit për dënimet alternative;
- shkëmbimin e informacionit mbi personat nën mbikëqyrje që kanë kryer ose mund të kryejnë vepra penale;
- zbatimin e masës së dënimit me “gjysmë liri”.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- Ligjin nr. 78/2020, datë 25.06.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, të ndryshuar me ligjin nr. 90/2024;

- V.K.M nr. 421, datë 08.07.2021, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës”;
- V.K.M nr. 209, datë 06.04.2022, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i marrëveshjes është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale, për të siguruar:

- koordinim më të mirë në vlerësimin, mbikëqyrjen dhe rehabilitimin e të dënuarve;
- një proces të unifikuar komunikimi dhe raportimi ndërmjet institucioneve;
- realizimin efektiv të masave alternative dhe të “gjysme lirisë”, në përputhje me vendimet gjyqësore dhe rregulloret përkatëse.

Neni 4

Detyrimet e palëve

A. Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës

1. Të depozitojë pranë çdo IEVP-je listën emërore të specialistëve sipas Degëve Territoriale të Shërbimit të Provës dhe çdo ndryshim të saj.
2. Të pajisë çdo specialist të Shërbimit të Provës me autorizimin e posaçëm të lëshuar nga Drejtuesi i Degës Territoriale për zhvillimin e intervistës dhe hartimin e raportit të vlerësimit. Autorizimi përmban:
 - emrin e specialistit;
 - emrin e të dënuarit;
 - IEVP-në përkatëse;
 - datën dhe orën e takimit.
3. Të dorëzojë një kopje të autorizimit në IEVP në momentin e paraqitjes së specialistit.
4. Merr pjesë në përcaktimin e IEVP-së për zbatimin e masës, nëpërmjet urdhrit të përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
5. Të hartojë dhe zbatojë planin individual ditor për çdo të dënuar në “gjysmë liri” në përputhje me vendimin gjyqësor dhe rregulloret përkatëse dhe të monitorojë zbatimin e tij.
6. Monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e planit, duke verifikuar respektimin e orareve, kontakteve dhe kushteve të tjera.
7. Të raportojë menjëherë te prokurori dhe drejtuesi i IEVP-së për çdo shkelje të kushteve të masës.
8. Të përgatisë raporte periodike mbi ecurinë e rasteve dhe efektivitetin e masave të dënimit alternativ dhe ia përcejell organit kompetent për vendimmarrje.
9. Të marrë pjesë në grupet e përbashkëta të punës për vlerësimin e praktikave dhe trajnimin e stafit.

B. Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

1. Specialistët e Shërbimit të Provës, të cilët janë të autorizuar nga Degët Territoriale të Shërbimit të Provës për të ushtruar funksionet e tyre pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, të pajisen me autorizim hyrjeje nga drejtori i IEVP përkatës.
2. Të sigurojë ambientet dhe kushtet për zhvillimin e intervistave të të dënuarve me specialistët e Shërbimit të Provës.
3. Të respektojë oraret e përcaktuara për takimet dhe intervistat.
4. Të garantojë sigurinë fizike dhe integritetin e specialistëve gjatë takimeve në ambientet e IEVP-ve.
5. Të njoftojë menjëherë Shërbimin e Provës për çdo shkelje të rregullave apo për kryerje të veprave penale nga të dënuarit.
6. Të sigurojë zbatimin e vendimit për “gjysmë liri” në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, duke kontrolluar hyrje-daljet, respektimin e orareve dhe raportimin periodik.
7. Të bashkëpunojë për shkëmbimin e informacionit mbi ecurinë dhe rezultatet e masave të dënimit alternativ dhe të “gjysmë lirisë”.

Neni 5

Mekanizmat e përbashkët të bashkëpunimit

Palët bien dakord të krijojnë një mekanizëm të përhershëm bashkëpunimi, i cili do të përfshijë:

1. Mbledhje periodike pranë ambienteve të DPB (të paktën çdo 6 muaj) për analizimin e zbatimit të marrëveshjes;
2. Shkëmbim të vazhdueshëm të informacionit operacional dhe teknik;
3. Hartimi i raporteve të përbashkëta mbi efektivitetin e masave.
4. Përgatitja e planeve vjetore të trajnimit për stafin e të dy institucioneve, në përputhje me urdhrat e përbashkët.

Neni 6

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni që u bëhet i ditur gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
2. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale bëhet vetëm për qëllime institucionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 7

Monitorimi dhe raportimi

1. Palët caktojnë nga një person përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e marrëveshjes, sipas të dhënave të përcaktuara në Aneksin 1.
2. Të dhënat për ecurinë e bashkëpunimit do të raportohen çdo (brenda datë 20 shkurt të çdo viti kalendarik) në një raport të përbashkët vlerësimi.

Neni 8
Ndryshimi i marrëveshjes

1. Çdo ndryshim bëhet vetëm me dakordësi të shkruar të palëve, pas njoftimit paraprak prej 30 ditësh.
2. Ndryshimi i personit të kontaktit njoftohet me shkrim brenda 7 ditëve kalendarike.

Neni 9
Kohëzgjatja dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kjo marrëveshje zbatohet për një periudhë pa afat.
2. Çdo mosmarrëveshje në interpretim ose zbatim zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve.

Neni 10
Hyrja në fuqi dhe dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.
2. Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.
3. Kjo marrëveshje nuk krijon detyrime financiare për asnjërën palë.

PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË PROVËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
(Në mungesë)

DREJTORI I MBIKËQYRJES
ELEKTRONIKE



PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
BURGJEVE

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

KLEVIS QOSE



Aneksi 1: Personat e Kontaktit.

Përfaqësues për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës:

Emër Mbiemër: Kejsi Previzi

Pozicioni: Specialist i Mbikqyrjes Elektronike

Adresa: Rruga "Jordan Misja", Ndërtesa 6/1, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tirane

Tel: +355 68 27 57 764

E-mail: kejsi.previzi@sherbimiproves.gov.al

Përfaqësues për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve:

Emër Mbiemër: Suela SENAJ

Pozicioni: Specialist/ Sektori Ndihmës i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve

Adresa: Rruga "Zef Serembe", Tufinë, Tiranë

Tel: 00355 68 54 483 86

E-mail: suela.senaj@dpbsh.gov.al